

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-22659  
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për disa klube sportive për vitin 2013, kryetari i Komunës më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të disa klube sportive për vitin 2013 lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të tyre. Kështu që klubet sportive që përkrahen financiarisht janë:

1. Klubi i hendbollit "Prizreni" F - .... 3000 €,
2. Klubi i basketbollit "Bashkimi" F... 1500 €,
3. Klubi i hendbollit "Prizren" M -.....1500 €,
4. Klubi i çiklistik "Prizreni".....1500 €,
5. Klubi i mundjes "Prizreni".....1500 €,
6. Klubi i atletikës "Prizreni" .....1500 €,
7. Klubi i boksit "Prizreni".....1000 €,
8. Klubi i xhudos "Prizreni".....1000 €,
9. Klubi i tenisit "Prizreni".....1000 €,
10. Klubi i shahut "Zhupa"..... 500 €,
11. Klubi i pingpongut "Prizreni".....500 €,
12. Klubi i pingpongut "Elif 19".....500 €,
13. Klubi i karatesë "Prizreni".....500 €, dhe
14. Klubi i karatesë "Elmedina".....500 €.

Gjithsej shuma e përgjithshme e mjeteve që lejohet në emër të përkrahjes financiare për klubet sportive të lartcekura është 16.000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-22663  
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për Teatrin Profesional të Prizrenit, kryetari i Komunës më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 4.9.2013, për mbështetje financiare për Teatrin Profesional të Prizrenit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve lidhur me realizimin e projekteve teatrore, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 5000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Mulla





EC MA NDRYSHE

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-28026  
Më 24.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për përkrahje financiare të disa ShKA-ve për vitin 2013, kryetari i Komunës më 24 shtator 2013, miratoi këtë:

**V E N D I M**  
**PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI**

**Neni 1**

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 17.9.2013, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të disa ShKA-ve për vitin 2013, lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të tyre, kështu që ShKA-të që përkrahen financiarisht janë:

- 1. ShKA "Agimi"- Prizren me.....2000 €,
- 2. AKV "Lidhja e Prizrenit" -Prizren me. ....2000 €,
- 3. AAKV "Emin Duraku" -Zhuri me.....2000 €,
- 4. ShKA "Muharrem dhe Xhevat Qena"-Romaja me... ..2000 €,
- 5. ShKA "Dogru Yol"- Prizren me.....1500 €,
- 6. ShKA "Podgorski Biseri" me .....1500,
- 7. ShKA "Katarina Josipi" nga Zymi me .....1000 €,
- 8. ShKA "Sarski Behar" me .....1000 €,
- 9. ShKA "Durmish Asllano"-Prizren me .....1000 €, dhe
- 10. ShKA "Mesk"- Prizren me.....1000 €.

Gjithsej shuma e përgjithshme e mjeteve që lejohet në emër të përkrahjes financiare për ShKA-të e lartcekura është 15000 €.

**Neni 2\***

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

